



| | | | |
|--|----------------------|----------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Punë/Proceduro Received/Delivered | 14.06.2021 | 1 | viti god year |
| Organ / Institucioni Org / Inst | Pr. Proct Prct No | Shtesa Emëg Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKIPNESHICK | 3059/2021 | | 113 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.458/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyla Gojnovci-Millaku - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas aktgjykimit me numër A.nr.2703/19 të datës 21.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.590/2019 të datës 30.09.2019 të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 14.06.2021 mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.590/2019 të datës 30.09.2019 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi nëpunës civil pranë Administratës Tatimore të Kosovës, ka parashtruar ankesën me numër protokoll 4589 të regjistruar me numër A.nr.590/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër shpalljes së konkursit të brendshëm të datës 17.09.2019 për pozitën e punës; Drejtor i Departamentit të Hetimeve Tatimore, Drejtor të Departamentit të Regjistrimit dhe Shërbimit të Tatimpaguesve, dhe pozitën Drejtor i Departamentit të Tatimpaguesve të Mëdhenj, me pretendimin ankimor se shpallja e këtyre konkurseve është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil, duke pretenduar që të anulohet konkursi i datës 17.09.2019 deri sa të sistemohet në pozitë konform legjislacionit në fuqi, sepse i njëjti për shkak të shuarjes së pozitës me datë 13.06.2019 është caktuar nga pozita e punës Drejtor i Departamentit të Lojërave të Fatit, në pozite me të ulët Udhëheqës i Ekipit të Mbledhjes së Detyrueshme, i cili me datë 14.05.2019, ka pranuar njoftimin e Drejtorit i Përgjithshëm për miratim e strukturës së re organizative të Administratës Tatimore të Kosovës.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 14.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, me datë 23.09.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa ky i fundit me datë 26.09.2019 ka njoftuar ankuesin se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik, ankesa parashtrohet drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Ankuesi, pasi ka pranuar njoftimin e datës 26.09.2019, me datës 30.09.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 04.10.2019 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Administratën Tatimore të Kosovës. Këshilli, me datë 16.10.2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me datë 21.05.2021 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.2703/19 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtojë dhe të vendos për ankesën e datës 30.09.2019 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 30.09.2019 me numër protokollit 4589/2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Projekt Rregulloren nr.ATK13/2019 të datës 17.05.2019; Njoftimin e datës 26.09.2019 Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Email i datës 17.09.2019; Shpallja e konkursit të brendshëm i datës 17.09.2019; Vendimi më numër prot:333 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së të datës 13.06.2019; Ankesa e datës 23.09.2019 parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Akte emërimi i datës 15.05.2018; Vendimi Nr.87/2018 i datës 04.05.2018 i miratuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me raport të datë 08.05.2018; Përgjigje në ankesë e datës 16.10.2019 nr. protokollit 4880/2019; Strukturën organizative të ATK-së të datës 10.05.2019; E-mail njoftues i datës 24.06.2016; E-mail i datës 16.05.2019; E-mail i datës 14.05.2019, dërguar nga _____ për ankuesin dhe të tjerët nëpunës; Shkresë përcjellëse e datës 26.09.2019 nga Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, me numër protokollit 11/196.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për **Përfundimin e Procedimit Administrativ** të filluar sipas ankesës me numër A.nr.590/2019, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke iu referuar dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 ku përcaktohet se: *"Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike"*, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrative, sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës sipas Aktgjykimit A.nr.2451/2019 të Gjykatës Themelore në



Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 28.05.2021 ka nxjerrë Vendimin A.nr.336/2021 përmes të cilit ka vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të datës 04.09.2019, ankesë e cila ka pasur të njëjtin qëllim dhe është bazuar mbi të njëjtën situatë faktike sikurse ankesa e datës 30.09.2019 e cila për objekt shqyrtimi ka Vendimin më numër prot:333 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së të datës 13.06.2019. Andaj meqenëse paraprakisht është vendosur lidhur me objektin e njëjtë të ankesës, gjegjësisht sistemimin e ankuesit për shkak të shuarjes së pozitës, Kolegji vendosi për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me ankesën A.nr.590/2019 të parashtruar nga ankuesi

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me A.nr.458/2021

Zyle Millaku GOJNOVCI
Procesmbajtëse

Jeton KOCA
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Menaxherit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

